

# RENOFIX 66

LLAÇ I LEHTË ME PERLIT PËR PËRPUNIM THEMELOR  
 TË MUREVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME

## Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik!

### HAPËSIRAT E PËRDORIMIT:

Llaç i lehtë me perlit për mure të brenshme dhe të jashtme mbi të gjitha bazamentet poroze, si tulla, porobetone, pllaka ndërtimore të lehta etj. Veçanërisht mbi mur të lehtë, mur poroz nga guri si dhe për tulla poroze, lesh druri, pllaka nga pluhuri I drurit etj. Llaç themelor për llaçe strukturale dhe dekorative, silikate, silikone dhe llaçe në bazë të smollës artificiale.

### PËRMBAJTJA:

- Çimento
- Glëqere
- Gur gëlqeror të kualitetit të lartë
- Shtesë të lehtë organike (perlit)
- Shtesa të cilat i përmirësojnë veçoritë e përpunimit

### VEÇORITË:

- Produktivitet i lartë
- Kualitet i lartë i përpunimit

### PËRGATITJA E BAZËS:

Bazamenti duhet të jetë i sheshtë (i rrafshuar), i thatë, I pasëtr nga pluhuri, mbeturinat dhe vajrat. Udhëzimet e përpunimit janë të vlefshme për muret që janë të ndërtuar me norma të caktuara dhe që nënkuptojnë mure me fuga të mbyllura. Nëse muri ka fuga të hapura apo çarje, të njejtat paraprakisht duhet të mbyllën. Sipërfaqet e lëmuara të betonit patjetër të lyhen me Renofix 5 (urë lidhëse).

### PËRGATITJA E LLAÇIT:

Gjatë përgatitjes me dorë, një thes Renofix 66 përzihet me mikser për 2 minuta me rreth 8-9 litra ujë të pastër; materiali vendoset mbi bazamentin dhe tërhiqet me rrafshues (gletkele). Me makinën Skure-Tech S4 spërkaten muret. Spërkatja bëhet mbi sipërfaqe të njomë (të lagur). Shfrytëzimi i materialit bëhet brenda 2 orëve.

### PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT:

Materiali mbi bazamentin vendoset me mistri në dorë apo me makinën e llaçit Skure-Tech S4. Pas vendosjes materiali rrafshohet me llajsne alumini. Pasi shtesa e vendosur të ngurtësohet dhe në varës nga përpunimi final I sipërfaqes, duhet paraprakisht të kryhet filcimi, apo me ndihmën e veglës speciale të bëhet ashpërsimi me qëllim të vendosjes së shtresës tjetër. Trashësia minimale e shtresës është 10 mm, por nëse është nevoja mund të vendosen disa shtresa të llaçit. Materiali shfrytëzohet brenda 2 orëve. Gjatë kohës së ngurtësimit, duhet të sigurohen kushte të mira për tharje dhe qarkullim të ajrit (korent I ajrit). Të ruhet nga ngrirja. **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzierja me materiale tjera..



### VËRREJTJE:

Përmban çimento dhe glëqere. Irriton sytë dhe lëkurën. Gjatë rasteve të këtylla, sytë dhe lëkura të lahen me ujë të pastër.

### PAKETIMI:

Në thasë letre nga 35kg. që janë të mbrojtura nga lagështia.



### DEPONIMI:


Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 6 muaj..

# RENOFIX 66

<b>Të dhëna teknike:</b>	
<b>Numri i prodhimit:</b>	5319990620170
<b>Shifra e prodhimit:</b>	1066
<b>Thasë në paletë:</b>	30
<b>Granulacioni:</b>	1,2 mm
<b>Sasia e nevojshme e ujit:</b>	8,5-9 l/thes
<b>Trashësia minimale e shtresës:</b>	10 mm
<b>Harxhimi:</b>	Për trashësi prej 10 mm, 10 kg/m <sup>2</sup>
<b>Shënim:</b>	Vlerat e harxhimit janë aproksimative dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.
<b>Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10):</b>	ca. 1.400 kg/m <sup>3</sup>
<b>Percjellshmëria e nxehtesise (1745:2000):</b>	0,51 W mk
<b>Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11):</b>	ca. 3,6 N/mm <sup>2</sup>
<b>Elasticiteti pas 28 ditëve (EN 1015-11):</b>	ca. 1,7 N/mm <sup>2</sup>
<b>Reagimi gjatë djegjes:</b>	A 1
<b>(EN 998-1):</b>	LW CS II WO

## Udhëzime të përgjithshme:

Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në disponimin tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjendjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: [www.renova.com.mk](http://www.renova.com.mk) si (pdf) ose mund t'i kërkontë në sektorin e shitjes.



RENOVA PUTZ | [www.renova.com.mk](http://www.renova.com.mk)

RENOVA Xhepcisht, Tetovë, Maqedoni | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | [info@renova.com.mk](mailto:info@renova.com.mk)  
 RENOVA Gureza, Urosevac, Kosovo | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | [renova\\_ferizaj@hotmail.com](mailto:renova_ferizaj@hotmail.com)  
 RENOVA Vore, Tiranë, Albanija | Tel.: 00355 48 301 909 | Fax: 00355 48 301 908 | [renova.tirana@hotmail.com](mailto:renova.tirana@hotmail.com)